



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Ligji Nr. 05/L-137**

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES PËRKITAZI ME  
THEMELIMIN E FONDIT TË BALLKANIT PERËNDIMOR**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës;**

Në mbështetje të neneve 18 dhe 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miratton:

**LIGJ PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES PËRKITAZI ME  
THEMELIMIN E FONDIT TË BALLKANIT PERËNDIMOR**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Me anë të këtij ligji ratifikohet Marrëveshja për themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor.

**Neni 2**  
**Fushëveprimi**

Fushëveprimi i këtij ligji është Marrëveshja për themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor, e miratuar si nismë nga Qeveria e Republikës së Kosovës me vendimin nr. 12/58 të datës 12.11.2015, si dhe me nënshkrimin e Marrëveshjes për themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor, më datë 13.11. 2015, në Pragë.

**Neni 3**  
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 05/L-137**  
**30 mars 2017**

**Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,**

---

**Kadri VESELI**

**MARRËVESHJE PËRKITAZI ME THEMELIMIN E  
FONDIT TË BALLKANIT PERËNDIMOR**

Qeveritë e Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Kosovës, Republikës së Maqedonisë, Malit të Zi dhe Republikës së Serbisë, (në tekstin e mëtejme të referuar si "Palët Kontraktuese"),

Të udhëhequr nga dispozitat e Deklaratës së Përbashkët të Ballkanit Perëndimor të nënshkruar më 31 Tetor 2014 në Bratislavë,

**BIEN DAKORD SI NË VIJIM:**

### **Neni 1**

Nëpërmjet kësaj, themelohet Fondi i Ballkanit Perëndimor (në tekstin e mëtejme të referuar si "Fondi") me selinë e saj në Tiranë.

### **Neni 2**

Nëpërmjet kësaj, miratohet Statuti i Fondit dhe do të përbëj një aneks të këtij dokumenti.

### **Neni 3**

Kjo Marrëveshje dhe anekset e saj këtu, mund të ndryshohen me shkrim me pëlqimin e të gjitha Palëve Kontraktuese.

### **Neni 4**

1. Kjo Marrëveshje do të jetë e hapur për nënshkrim nga Palët Kontraktuese.

2. Kjo Marrëveshje do të miratohet në përputhje me legjislacionin përkatës të secilës Palë Kontraktuese dhe do të hyjë në fuqi nga dita në të cilën instrumenti i fundit që vërteton miratimin e këtij dokumenti është depozituar pranë Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, që vepron si Depozitar.

### **Neni 5**

Qeveria e Republikës së Shqipërisë, që vepron si Depozitar, do të njoftojë të gjitha Palët Kontraktuese për depozitimin e të gjitha instrumenteve që vërtetojnë miratimin, hyrjen në fuqi të këtij dokumenti, si dhe të çdo fakti tjetër që lidhet me këtë Marrëveshje.

## **Neni 6**

1. Secila Palë Kontraktuese mund të tërhiqet nga kjo Marrëveshje në çdo kohë nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar Depozitarit, i cili më pas do t'ia transmetojë një kopje të vërtetuar të atij njoftimi secilës Palë Kontraktuese.
2. Tërheqja hyn në fuqi gjashtë muaj nga data në të cilën njoftimi është pranuar nga Depozitari.
3. Shpërndarja e Fondit, në përputhje me Statutin e Fondit, do të përbëj përfundimin e kësaj Marrëveshjeje në marrëdhëniet e saj me të gjitha Palët Kontraktuese.

## **Neni 7**

1. Qeveria e Shqipërisë do të veprojë si Depozitar i kësaj Marrëveshjeje.
2. Originali i kësaj Marrëveshjeje, në një kopje të vetme në Gjuhën Angleze, do të depozitohet pranë Depozitarit i cili do t'ia transmetojë një kopje të vërtetuar secilës Palë Kontraktuese.

NË DËSHMI TË KËSAJ, të nënshkruarit, të autorizuar sipas rregullit nga Qeveritë e tyre përkatëse, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Bërë në ..... më ..... në vitin dy mijë e pesëmbëdhjetë në një kopje të vetme origjinale në Gjuhën Angleze.

Republika e Shqipërisë:  
Bosnja dhe Hercegovina:  
Kosova:  
Republika e Maqedonisë:  
Mali i Zi:  
Republika e Serbisë:

## **STATUTI I FONDIT TË BALLKANIT PERËNDIMOR KAPITULLI I PARË QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT**

### **Neni 1**

Qëllimi i Fondit do të jetë për të promovuar:

- zhvillimin e bashkëpunimit më të ngushtë ndërmjet Palëve Kontraktuese;
- forcimin e lidhjeve ndërmjet Palëve Kontraktuese;
- integrimin e Palëve Kontraktuese në Bashkimin Evropian;
- prezantimin e përbashkët të Palëve Kontraktuese në vendet e treta.

## **Neni 2**

Objektivat e Fondit do të ndiqen përmes mbështetjes financiare të aktiviteteve në çdo fushë që kontribuon në bashkëpunimin ndër-rajonal dhe ndërkufitar, dhe në forcimin e kohezionit rajonal, në veçanti në fushat e mëposhtme:

- promovimin dhe zhvillimin e bashkëpunimit kulturor;
- promovimin dhe zhvillimin e shkëmbimeve shkencore, hulumtimit dhe bashkëpunimit në fushën e arsimit ndërmjet Palëve Kontraktuese;
- promovimin dhe zhvillimin e shkëmbimeve ndërmjet të rinjve;
- promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm të Palëve Kontraktuese.

Bashkëpunimi ndërmjet Palëve Kontraktuese në këto fusha të rregulluara në bazë të traktateve tjera ndërkombëtare nuk do të preken.

## **Neni 3**

Fondi mund të mbështes projekte me origjinë nga vende të tjera përveç të Palëve Kontraktuese, me kusht që ato të kenë së paku dy (2) partnerë bashkë-organizatorë nga Palët Kontraktuese dhe se tema e projekteve duhet të jetë e lidhur me rajonin e Ballkanit Perëndimor.

## **KAPITULLI I DYTË SELIA DHE ANËTARËSIMI**

### **Neni 4**

Palët Kontraktuese të kësaj Marrëveshjeje do të jenë Themeluesit e Fondit. Selia e Fondit do të jetë në Tiranë, Republika e Shqipërisë.

## **KAPITULLI I TRETË STRUKTURA ORGANIZATIVE**

### **Neni 5**

Organet drejtuese të Fondit do të jenë:

- Konferenca e Ministrave të Punëve të Jashtme;
- Këshilli i Zyrtarëve të Lartë;
- Drejtori Ekzekutiv;
- Sekretariati;

### **Neni 6**

Fondi do të ketë dhe do të përdor, si shkak mund të kërkojnë, një Vulë që ka një mekanizëm apo shtypje me mbishkrimin “Fondi i Ballkanit Perëndimor”. Vula e Fondit do të mbahet nën përkujdesjen e Drejtorit Ekzekutiv.

**KAPITULLI I KATËRT**  
**KONFERENCA E MINISTRAVE TË PUNËVE TË JASHTME**

**Neni 7**

Konferenca e Ministrave të Punëve të Jashtme do të jetë organi suprem i Fondit.

**Neni 8**

Konferenca e Ministrave të Punëve të Jashtme do të përbëhet nga Ministrat e Punëve të Jashtme të Palëve Kontraktuese ose përfaqësuesve të tyre të autorizuar.

**Neni 9**

Konferenca e Ministrave të Punëve të Jashtme do të caktojë nga radhët e anëtarëve të saj Kryesuesin e saj, me Kryesinë në Detyrë me rotacion, të emrave të Palëve Kontraktuese të renditur në mënyrë alfabetike Angleze.

**Neni 10**

Mandati i Kryesuesit të Konferencës së Ministrave të Punëve të Jashtme do të jetë një vit pa mundësinë e rinovimit.

**Neni 11**

Konferenca e Ministrave të Punëve të Jashtme miraton buxhetin e Fondit, deklaratat vjetore dhe autorizimin e buxhetit të prezantuar nga Këshilli i Zyrtarëve të Lartë.

Konferenca e Ministrave të Punëve të Jashtme do t'ua përcaktojë Palëve Kontraktuese kontributet vjetore dhe afatet e tyre të pagesës.

**Neni 12**

Konferenca e Ministrave të Punëve të Jashtme miraton planet vjetore dhe afatgjate përkitazi me aktivitetet e Fondit.

**Neni 13**

Konferenca e Ministrave të Punëve të Jashtme miraton aplikimet për Anëtarësim në FBP dhe pranimin e tyre në FBP.

#### **Neni 14**

Konferenca e Ministrave të Punëve të Jashtme do të aprovoj/miratoj Rregulloren e Punës së Sekretariatit dhe mund të vendosë për ndryshimet në të.

#### **Neni 15**

Konferenca e Ministrave të Punëve të Jashtme do të miratoj vendime me konsensus.

#### **Neni 16**

Konferenca e Ministrave të Punëve të Jashtme do të mbledhet të paktën një herë në vit. Kryesuesi i Konferencës së Ministrave të Punëve të Jashtme do të caktojë vendin dhe datën e seancave të saj.

### **KAPITULLI I PESTË KËSHILLI I ZYRTARËVE TË LARTË**

#### **Neni 17**

Këshilli i Zyrarëve të Lartë do të përbëhet nga Zyrarë të Lartë të Ministrive të Punëve të Jashtme të Palëve Kontraktuese, apo përfaqësues tjerë të emëruar sipas rregullit.

#### **Neni 18**

Seancat e Këshillit të Zyrarëve të Lartë do të kryesohen nga Fuqiploti i Palës Kontraktuese përfaqësuesi i së cilit mban postin e Kryesuesit të Konferencës së Ministrave të Punëve të Jashtme.

#### **Neni 19**

Këshilli i Zyrarëve të Lartë do të përgatisë programet e aktiviteteve të Fondit dhe raportet mbi zbatimin e tyre në vitin paraprirës dhe i paraqet ato për miratim në Konferencën e Ministrave të Punëve të Jashtme.

#### **Neni 20**

Këshilli i Zyrarëve të Lartë përgatit projekt buxhetet e Fondit dhe raportet për shfrytëzimin e tyre në vitin paraprirës dhe i paraqet ato për miratim në Konferencën e Ministrave të Punëve të Jashtme.



### **Neni 21**

Këshilli i Zyrtarëve të Lartë përcakton udhëzime të detyrueshme për aktivitetet e Drejtorit Ekzekutiv dhe normat që rregullojnë përgatitjen, pranimin dhe zbatimin e projekteve të dorëzuara në Fond, duke marrë parasysh normat që rregullojnë të drejtat dhe detyrat e Drejtorit Ekzekutiv të përcaktuara nga Konferenca e Ministrave të Punëve të Jashtme.

### **Neni 22**

Këshilli i Zyrtarëve të Lartë do të hartojë programe dhe dokumente për seancat e Konferencës së Ministrave të Punëve të Jashtme.

### **Neni 23**

Këshilli i Zyrtarëve të Lartë do të miratoj vendime me konsensus.

### **Neni 24**

Këshilli i Zyrtarëve të Lartë do të mblidhet të paktën një herë në gjashtë muaj, dhe ndërmjet këtyre periudhave sa herë që e konsideron të përshtatshme, për zbatimin e objektivave të përcaktuara në Kapitullin e Parë. Kryesuesi i Këshillit të Zyrtarëve të Lartë cakton vendin dhe datën e seancave të saj.

### **Neni 25**

Këshilli i Zyrtarëve të Lartë miraton Rregullat e Punës që do të jenë subjekt i miratimit nga Konferenca e Ministrave të Punëve të Jashtme.

### **Neni 26**

Këshilli i Zyrtarëve të Lartë mund t'i propozoj Konferencës së Ministrave të Punëve të Jashtme ndryshime në Rregulloren e Punës së Sekretariatit, për t'u miratuar në përputhje me Nenin 14.

## **KAPITULLI I GJASHTË DREJTORI EKZEKUTIV, ZËVENDËS DREJTORI EKZEKUTIV DHE SEKRETARIATI**

### **Neni 27**

Drejtori Ekzekutiv do të shërbej si Kryeshf Ekzekutiv i Fondit dhe do të përfaqësoj Fondin. Drejtori Ekzekutiv do të jetë përgjegjës për zbatimin e objektivave të Fondit dhe performancës së tij efektive.

Drejtori Ekzekutiv do të autorizohet për të përfaqësuar Fondin dhe interesat e tij, dhe do të bëjë paraqitje në emër të Fondit. Në emër të Fondit, Drejtori Ekzekutiv do të autorizohet nga Konferenca e Ministrave të Punëve të Jashtme të nënshkruaj Marrëveshjen ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Ballkanit Perëndimor dhe marrëveshjeve tjera relevante për funksionimin e Fondit.

Drejtori Ekzekutiv do të udhëheq Sekretariatit.

Drejtori Ekzekutiv do të udhëheq të gjitha përpjekjet për mbledhjen e fondeve në emër të Fondit të Ballkanit Perëndimor.

Drejtori Ekzekutiv do të përgatis raporte dhe buxhetin për organet përkatëse vendimmarrëse.

Drejtori Ekzekutiv do të koordinoj lansimin e thirrjes për propozime, vlerësimet për projekt propozimet dhe do të përgatis rekomandimet për veprim në lidhje me grantet Këshillit të Zyrarëve të Lartë për vendim.

Drejtori Ekzekutiv do të koordinoj monitorimin dhe vlerësimin e projekteve të realizuara.

Drejtori Ekzekutiv do të udhëtoj herë pas here në rajon duke kontaktuar palët e interesuara dhe duke ndjekur ngjarjet që lidhen me aktivitetet e Fondit.

Drejtori Ekzekutiv do të zhvilloj dhe koordinoj komunikimin e Fondit.

## **Neni 28**

Secila Palë Kontraktuese ka të drejtë të propozoj kandidatin e saj për pozitën e Drejtorit Ekzekutiv dhe Zëvendës Drejtorit Ekzekutiv. Drejtori Ekzekutiv dhe Zëvendës Drejtori Ekzekutiv do të emërohen nga Konferenca e Ministrave të Punëve të Jashtme me konsensus. Mandati i Drejtorit Ekzekutiv dhe Zëvendës Drejtorit Ekzekutiv do të jetë tri vite dhe pa mundësinë e rinovimit përveç nëse përcaktohet ndryshe nga Konferenca e Ministrave të Punëve të Jashtme.

## **Neni 29**

Konferenca e Ministrave të Punëve të Jashtme do të përcaktoj normat që rregullojnë të drejtat dhe detyrat e Drejtorit Ekzekutiv dhe Zëvendës Drejtorit Ekzekutiv, mënyrën sipas së cilës ato duhet të përmbushen si terma të detyrave të Drejtorit Ekzekutiv dhe Zëvendës Drejtorit Ekzekutiv.

## **Neni 30**

Drejtori Ekzekutiv do të marrë pjesë në seancat e Konferencës së Ministrave dhe Këshillit të Zyrarëve të Lartë në një cilësi këshilluese.

## **Neni 31**

Drejtori Ekzekutiv do të jetë përgjegjës për funksionimin e Sekretariatit dhe, në përputhje me legjislacionin e Palës Kontraktuese në territorin e së cilës Fondi ka selinë e saj, do të përcaktoj termat dhe kushtet e punësimit për personelin e Sekretariatit në përputhje me rregullat e miratuara nga Konferenca e Ministrave të Punëve të Jashtme.

### **Neni 32**

Drejtori Ekzekutiv në mënyrë të rregullt do të informoj Kryesuesin e Këshillit të Zyrtarëve të Lartë për mënyrën, sipas së cilës është zbatuar programi i aktiviteteve të Fondit, të përgatis pasqyrat vjetore dhe autorizimin e buxhetit të Fondit.

### **Neni 33**

Sekretariati do të jetë përgjegjës për shërbimet e ofruara gjatë seancave të Këshillit të Zyrtarëve të Lartë dhe shërbimeve të ofruara në lidhje me seancat e Konferencës së Ministrave të Punëve të Jashtme, si dhe për shërbimet tjera që lidhen me funksionimin e Fondit.

### **Neni 34**

Përgjegjësitë e Drejtorit Ekzekutiv do të jenë të një karakteri ekskluzivisht ndërkombëtar. Në kryerjen e detyrave të tij/saj, Drejtori Ekzekutiv do të ndjek rregullat e përcaktuara nga Konferenca e Ministrave të Punëve të Jashtme dhe nuk do të pranoj udhëzime nga palët e treta.

Në kryerjen e detyrave të tyre, Drejtori Ekzekutiv dhe Personeli i Sekretariatit të FBP-së nuk duhet të kërkojnë, pranojnë apo veprojnë sipas udhëzimeve të ndonjë qeverie apo të ndonjë autoriteti tjetër jashtë Fondit.

Secila Palë Kontraktuese merr përsipër të respektoj karakterin ekskluzivisht ndërkombëtar të përgjegjësive të Drejtorit Ekzekutiv dhe Personelit të Sekretariatit, dhe nuk do të përpiqet të ndikoj në to gjatë kryerjes së përgjegjësive të tyre.

### **Neni 35**

- (1) Stafi i FBP-së do të përbëhet nga personat që punojnë nën autoritetin e Drejtorit Ekzekutiv dhe Zëvendës Drejtorit Ekzekutiv.
- (2) Stafi i FBP-së do të përbëhet nga përfaqësues të Palëve Kontraktuese, duke marrë parasysh përfaqësimin adekuat të të gjitha Palëve Kontraktuese.
- (3) Rregulloret e Personelit duhet të përfshijnë rregullat, parimet dhe procedurat që rregullojnë përzgjedhjen e personelit, rekrutimin e tyre, klasifikimin e pozitave, dhe funksionimin efikas të Sekretariatit të FBP-së në arritjen e objektivit të këtij Statuti.

### **Neni 36**

Gjuha zyrtare e Fondit do të jetë Gjuha Angleze.

## **KAPITULLI I SHTATË STATUSI LIGJOR I FONDIT**

### **Neni 37**

Fondi ka individualitet të plotë ligjor të nevojshëm për përmbushjen e qëllimeve që lidhen me aktivitetet e tij.

## **KAPITULLI I TETË FINANCAT**

### **Neni 38**

Aktivitetet e Fondit do të financohen nga kontributet e bëra nga Palët Kontraktuese dhe kontributet financiare nga burimet tjera të miratuara nga Këshilli i Zyrtarëve të Lartë.

### **Neni 39**

Secila Palë Kontraktuese do të marrë përsipër të siguroj një kontribut vjetor për Fondin brenda gjashtëmujorit të parë të çdo viti. Kontributi vjetor i çdo Pale Kontraktuese për Fondin do të jetë 30,000.00 € (tridhjetë mijë Euro). Shuma e kontributit vjetor mund të ndryshoj me vendim të Konferencës së Ministrave të Punëve të Jashtme.

### **Neni 40**

Normat që rregullojnë shfrytëzimin e mjeteve financiare të Fondit do të përcaktohen nga Konferenca e Ministrave të Punëve të Jashtme.

### **Neni 41**

Fondi do të hapë llogarinë e tij bankare në Palën Kontraktuese duke siguruar selinë e Fondit. Burimet financiare të Fondit do të mbahen në këtë llogari bankare. Fondet do të administrohen nga Drejtori Ekzekutiv.

## **KAPITULLI I NËNTË SHPËRNDARJA E FONDIT**

### **Neni 42**

Pas vendimit të secilit Pjesëmarrës të Fondit të Ballkanit Perëndimor për t'u tërhequr nga Fondi i Ballkanit Perëndimor në bazë të Nenit 6 të Marrëveshjes përkitazi me themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor, Drejtori Ekzekutiv do t'i jap fund menjëherë cilido, dhe të gjitha aktiviteteteve, me përjashtim të aktiviteteteve që lidhen me mbledhjen e detyrimeve dhe likuidimit të pasurive dhe pagesave të detyrimeve.

### **Neni 43**

Në kuadër të disbursimit të pasurive, detyrimet e Fondit do të kenë prioritet përkundrejt kthimit të kontributeve.